VENDIM
Nr.610, datë 21.12.1999

PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT PJESOR TË VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË SHOQËRISË "M.LEKA" SHPK NË ADMINISTRIM, ME TË ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.55.1997, "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", neneve 3, 4 dhe 8 pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, 'Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1.Për shoqërinë "M.Leka" shp.k. në administrim, të fillojë procesi i kompensimit të kreditorëve mbi bazën e koeficientit pjesor të llogaritur si raport i të ardhurave të depozituara në bankë nga shitja e aseteve dhe shumës së detyrimit të mbetur, që shoqëria ka ndaj kreditorëve.

2.Të ardhurat financiare gjendje dhe ato të realizuara nga shitja e aseteve të marra në administrim, në shoqërinë "M.Leka" shpk dhe të depozituara në bankë, kapin vlerën 315 000 000 (treqind e pesëmbëdhjetë milionë) lekë. Shuma e detyrimit të mbetur (borxhi), që sdhoqëria "M.Leka", shp.k. në administrim ka ndaj kreditorëve është 930 000 000 (nëntëqind e tridhjetë) milionë lekë.

3.Koeficienti pjesor i kthimit të shumave kreditorëve nga shitja e aseteve llogaritet në masën 0.34 ose 34 për qind.

4.Shpërndarja e vlerave financiare, të kryhet nga degët e Bankës së Kursimeve, të rretheve Tiranë, Durrës dhe Vlorë, ku kreditori ka depozituar vlerat financiare, sipas listave të hartuara nga administratorët dhe të përpunuara nga Qendra e Informatizimit Financiar.

5.Shpenzimet për shërbimet, që do të kryhen në sportelet e degëve të Bankës së Kursimeve, për kthimin e vlerave financiare kreditorëve përballohen nga buxheti i grupit Mbikëqyrës.

6.Administratorët e përbashkët të shoqërisë "M.Leka" shpk në administrim, të bashkërendojnë punën me zyrat e përmbarimit gjyqësor, për arkëtimin e detyrimeve debitore, për kthimin e vlerave financiare të përfituara nga personat fizikë a juridikë, nga shitja e pasurive apo transaksioneve të pronësisë, dhe të vlerave financiare të transferuara jashtë territorit të Shqipërisë, me qëllim llogaritjen e koeficientit përfundimtar të kthimit të shumave kreditorëve.

7.Ngarkohen Ministria e Financave, Banka e Kursimeve, Grupi Mbikqyrës dhe administratorët e përbashkët të shoqërisë "M.Leka" shp.k. në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta